



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETËQEVERISESE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**

**MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY**

**MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU**

Kabineti i Ministrët

Minister's Cabinet

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Ndarja e shkollave të mesme të ulëta nga shkollat fillore

NUMËR: 3/2007

DATË: 31.01.2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë, të nenit 6 pika (b) dhe (c) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij UA është që të përcaktohet mënyra dhe procedura e ndarjes së shkollave të mesme të ulëta nga shkollat fillore.

Neni 2 Arsimi fillor

Të gjitha shkollat fillore ose niveli 1 (klasa 1-5) do të mbesin në objektet në të cilat e kanë zhvilluar dhe janë duke e zhvilluar veprimtarinë edukativo- arsimore.

Neni 3 Puna në objekte tjera

Shkollat e mesme të ulëta ose niveli 2 (klasa 6 – 9) do ta zhvillojnë veprimtarinë e vet edukativo- arsimore në objekte tjera nga shkolla fillore.

Neni 4
Dokumentacioni shkollor dhe vula

Shkolla fillore si dhe shkolla e mesme e ulët da ta kenë vulën dhe dokumentacionin shkollor përkatës sipas niveleve.

Neni 5
Puna në objektin e përbashkët

Në mungesë të objektit shkollor, sipas nenit 3 të këtij UA, SHMU mund ta zhvillojë veprimtarinë edukativo- arsimore në të njëjtin objekt të shkollës fillore, nëse janë mundësitë e ndarjes fizike në hyrje të veçanta.

Neni 6
Orari i mësimi në objektin e përbashkët

1. Në objektin e përbashkët, sipas nenit 5 të këtij UA veprimtaria edukativo-arsimore do të zhvillohet:
 - a) SHF do të punojë paradite,
 - b) SHMU do të punojë pasdite.
2. Në mungesë të lokalit dhe sipas nevojës shkolla fillore mund të shfrytëzojë klasa (dhoma mësimi) paradite, nëse ka vend ose të kundërtën SHMU të punojë pasdite në klasa të zbrazëta.
3. Për shfrytëzimin e klasave duhet të dakordohen të dy drejtorët për të cilën vendos Komisioni i DKA-së.

Neni 7
Komisioni

1. Komisionin e formon DKA- në përbërje prej 5 anëtarësh:
 - a) përfaqësuesi i DKA- së,
 - b) drejtori i shkollës,
 - c) përfaqësuesi i shkollës fillore,
 - d) përfaqësuesi i shkollës së mesme të ulët dhe
 - e) përfaqësuesi i prindërve
2. Komisionin e kryeson përfaqësuesi i DKA-së.

Neni 8

Përcjelljen e punës sipas nenet 6 paragrafi 2, e bën drejtori i nivelit përkatës pavarësisht se në cilin ndërrim mbahet mësimi.

Neni 9 **Kuadri arsimor**

1. Kuadri arsimor për shkolla fillore do të jetë i gjithë personeli i angazhuar në procesin mësimor për klasat 1-5.
2. Kuadri arsimor për shkolla të mesme të ulëta do të jetë ai kuadër i cili është i angazhuar në zhvillimin e mësimin lëndor në klasat 6-9.

Neni 10 **Përcaktimi i mësimdhënësve**

Në raste të veçanta kur një apo më shumë mësimdhënës janë të angazhuar në të dy nivelet, përcaktimin e tyre do ta bëjë Komisioni i shkollës.

Neni 11 **Kontratat e punës së kuadrit arsimor**

Kuadrit arsimor, do t'iu lëshohen kontratat e punës sipas niveleve në kohëzgjatje për atë sa i kanë kontratat të pranuar sipas konkursit të fundit.

Neni 12 **Personeli ndihmës**

Personelin ndihmës do ta caktojë nëpër nivele Komisioni i DKA-së .

Neni 13 **Kontratat e punës së personelit ndihmës**

Personeli ndihmës caktohet për njërin nivel për të cilin do ta marrë kontratën e punës.

Neni 14

1. Në rast kur një apo më shumë persona ndihmës duhet ta plotësojnë orarin e punës në ndërrimin tjetër respektivisht në nivelin tjetër, DKA-ja duhet t'iu lëshojë kontratat me orar të plotë të punës, me orë plotësuese në nivelin tjetër.
2. Personat sipas këtij neni do t'iu përgjigjen drejtorit përkatës por edhe drejtorit të DKA-së, për kryerjen apo moskryerjen e punës plotësuese.

Neni 15
Drejtori, kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës

1. Drejtorët aktual do të mbesin drejtorë të shkollave fillore.
2. Kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës së drejtorit do të jetë atëherë sa është në kontratën të cilën e ka në dispozicion, i pranuar sipas konkursit të fundit

Neni 16

Për SHMU, duhet të shpallet konkursi për drejtor, por punën e drejtorit do ta ushrojë deri në zgjedhjen e drejtorit të ri të SHMU, drejtori i shkollës fillore.

Neni 17

Drejtorët në objektet e përbashkëta, duhet ta kenë zyrën e vet për ushtrimin e detyrës së drejtorit.

Neni 18

Pjesëmarrja e komuniteteve në komision të shkollës

Në shkollat ku mësojnë dhe punojnë komunitetet joshqiptare, procedura e ndarjes së shkollave do të jetë e njëjtë por në komision të shkollës duhet të zgjedhet së paku një anëtar prej komunitetit përkatës.

Neni 19

Paralelet e ndara fizike

Ndarja e paraleleve të ndara fizike do të bëhet njëjtë me procedurën e ndarjes së shkollave amë.

Neni 20

Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen (menaxhimin) në paralelet e ndara do ta bëjnë drejtorët e nivelit përkatës,

Neni 21

1. Në paralelet e ndara drejtori do ta caktojë një përgjegjës paraleleje për nivelin përkatës.
2. Në raste të veçanta drejtori i DKA-së do ta caktojë një përgjegjës për të dy nivelet.

Neni 22 Inventari

Komisioni i DKA-së duhet ta bëjë ndarjen e inventarit të shkollës në proporcion me numrin e nxënësve dhe të punëtorëve tjerë.

Neni 23 Emërtimi

1. Shkollat fillore do t'i mbajnë emrat aktual të shkollave, të emërtuara sipas vendimit të organit përgjegjës për emërtimin e shkollave (MASHT-it).
2. Drejtori i shkollës së mesme të ulët mund t'i bëjë kërkesë MASHT-it për emërtimin e shkollës.
3. Emërtimi i shkollave do të bëhet në bazë të dispozitave në fuqi.

Neni 24 Procedura

Procedurën dhe dinamikën e punës do ta caktojë MASHT në bashkëpunim me DKA-të.

Neni 25 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Agim Veliu, ministër